



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V\_349\_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_516\_01\_11

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
4. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
5. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_516\_01\_11** ;
6. Apelimi i KEK-ut me datë 14.03.2011;

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Nexhmije Sylejman (parashtruesi i ankesës Eroll Halli), shifra e konsumatorit DPR – 92907 nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 29.01.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 26.01.2010 lidhur me kontestimin e faturës 06/2009.

- Me datë 03.03.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se ndërrimi i njehsorit është bërë prej KEK-PO, por që konsumatori nuk faturohet qe 5 vite. Numri i njehsorit të vjetër është 5330096, ndërsa njehsori i ri është 1563739 me gjendje TL=46414 dhe TU=21206.  
**Provë:** Procesi i KEK-ut nr. 268862 të datës 03.03.2009
- Me datë 18.03.2009 punëtorët e KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë hequr nga matje e energjisë elektrike njehsorin nr. 5330096 dhe kanë vendosur njehsorin elektrik nr. 1663739.  
**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 000683 të datës 18.03.2009
- Në muajin 06/2009 konsumatorit i ka arritur nga KEK-u fatura e energjisë elektrike prej **67,641.00** kWh/muaj, apo e shprehur financiarisht në vlerë prej 4,413.47 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 07.07.2009, 11.08.2009 dhe 28.10.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit 06/2009.  
**Provë:** Dëshmitë e ankesës së konsumatorit



- Me datë 26.01.2010 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e pranuar pjesërisht dhe duke informuar konsumatorin se për shkak të grumbullimit të kilovatëve për 52 muaj kemi bërë korrigjimet: me datë 29.08.2009 ka zbritur nga shuma e përgjithshme vlerën prej 3,512.24 €, me datë 07.10.2009 ka ngarkuar konsumatorin në shumën e përgjithshme në vlerë prej 307.43 € dhe me datë 19.01.2010 ka zbritur ka shume e përgjithshme në vlerë prej 214.58 €.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 26.01.2010
- Me datë 29.01.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit
- Me datë 31.01.2011 DMK ka lëshuar vendimin nr. ZRRE/DMK\_V\_ 516\_01\_11 dhe duke u bazuar në analizat e bëra ka vendosur që të aprovojë ankesën e konsumatorit dhe ka arritur në përfundim se:
  1. KEK-u për shkak të neglizhencës së tyre për 52 muaj, ku janë vonuar dhe nuk kanë regjistruar njehsorin elektrik, duhet të shkarkojnë konsumatorin nga fatura e muajit të gjatë 4413.47 € dhe korrigjimet e bëra të datës 29.08.2009, 07.10.2009 dhe 19.01.2010.
  2. Pasi që konsumatori gjatë periudhës së 06/2009 ka bërë shpenzim të energjisë elektrike atëherë KEK-u duhet që për këtë periudhë të faturoj konsumatorin me një mesatare të faturave të energjisë elektrike të sezonës verore të vitit 2010.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_ 516\_01\_11 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK **ZRRE/DMK\_V\_ 516\_01\_11** të mbetet në fuqi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar